

**PROGRAMI
I PROVIMIT**

QENDRA SHITËTËRORE E PROVIMEVE

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

PROVIMI PËRFUNDIMTAR

**ARSIMI I MEËM
PROFESIONAL**

Shkup, 2014

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE

PROGRAMI I PROVIMIT

**GJUHË SHQIPE
DHE LETËRSI**

**PËRFUNDIMTAR
NË ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL**

Programi i provimit përfundimtar është miratuar me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.

1. HYRJE

Gjuha shqipe dhe letërsia është lëndë që mësohet në arsimin e mesëm profesional gjatë katër viteve shkollore. Kjo lëndë qëllim themelor ka aftësimin e nxënësve për komunikim gojor dhe me shkrim në gjuhën standarde shqipe. Gjuha shqipe dhe letërsia nxënësit i aftëson për lexim analitik dhe kritik të veprave letrare.

Në bazë të Konceptcionit të arsimit të mesëm profesional, Provimi përfundimtar nga gjuha shqipe dhe letërsia për qëllim ka:

- ngritjen e cilësisë së arsimit të mesëm;
- përcjelljen dhe kontrollimin e realizimit të programeve mësimore nga gjuha shqipe dhe letërsia (mbështetur në standardet arsimore në nivel shtetëror);
- marrjen e certifikatit të arsimit të mesëm profesional (rrumbullakësimin e arsimit të mesëm);
- informimin e nxënësve, prindërve dhe institucioneve të tjera arsimore për sukseset e nxënësve nëpërmjet vlerësimeve (verifikimeve) adekuate.

Në bazë të Konceptcionit, lënda gjuhë shqipe dhe letërsi bën pjesë në lëndët e detyrueshme dhe është pjesë e provimit përfundimtar.

Dedikimi, baza dhe përmbajtja e Programit të provimit

Programi i provimit është dokument që u dedikohet nxënësve të arsimit të mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi themelor i këtij dokumenti është informimi i nxënësve me përmbajtjen dhe mënyrën e zbatimit të Provimit përfundimtar nga gjuha shqipe dhe letërsia. Provimi përfundimtar u dedikohet nxënësve të arsimit të mesëm profesional të cilët nuk përcaktohen për maturë shtetërore. Qëllimi i këtij provimi është marrja e dokumentit për kryerjen e arsimit të mesëm profesional.

Programi i provimit nga gjuha shqipe dhe letërsia mbështetet në programin mësimor të gjuhës shqipe dhe letërsisë që realizohet gjatë katër viteve shkollore. Lëmenjtë e kësaj lënde janë **GJUHA** dhe **LETËRSIA**, ndërsa dituritë e nxënësve do të verifikohen (kontrollohen) përmes aftësive: **Të folurit**, **Të lexuarit**, **Letërsi** (zbatimi dhe zotërimi i termeve të teorisë së letërsisë në vepra të njohura e të panjohura letrare) dhe **Të shkruarit**.

Programi i provimit ka këto komponente:

- Qëllimi i provimit
- Përmbajtja e provimit
- Rrjeti i specifikimit
- Konkretizimi i qëllimeve
- Përshkrimi i provimit
- Kriteret e vlerësimit.

2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I PROVIMIT TË MATURËS

Provimi përfundimtar nga lënda e gjuhës shqipe dhe letërsisë do të thotë rrumbullakësimin (vlerësimin përfundimtar) e diturive dhe aftësive të nxënësve që duhet t'i posedojnë në fund të procesit katërvjeçar arsimor dhe marrjen e certifikatit për arsimin e kryer të mesëm profesional.

Nxënësi duhet të jetë i aftësuar që:

- në mënyrë të pavarur të koncipojë dhe të përdorë të shprehurit gojor dhe me shkrim;
- t'i zbatojë rregullat drejtshkrimore dhe rregullat e të folurit të gjuhës standarde shqipe;
- të zotërojë interpretimin e një vepre të caktuar letrare në mënyrë kritike dhe analitike ;
- të lexojë tekste të njohura dhe të panjohura dhe të bëjë vlerësime kritike në mënyrë të pavarur.

3. PËRMBAJTJA E PROVIMIT

3.1. GJUHË

Qëllimet:

- zbatimi i normave gjuhësore të gjuhës standarde shqipe në komunikimin gojor dhe me shkrim.

Nxënësi duhet:

- t'i zbatojë rregullat e drejtshkrimit dhe rregullat e të folurit;
- individualisht dhe drejt të formulojë shprehje.

PËRMBAJTJET

GJUHË	
1. Shkenca mbi gjuhën	Gjuhë kombëtare - gjuhë dialektore - gjuhë standarde
2. Zhvillimi historik i gjuhës shqipe	Vendi i gjuhës shqipe në grupin e gjuhëve indoevropiane
3. Fonetikë dhe fonologji	Ndryshimet fonetike (në të folur)
4. Theksi në gjuhën shqipe	Theksi në gjuhën shqipe
5. Drejtshkrimi	- Përdorimi i shkronjës së madhe; - Shkrimi i fjalëve bashkë, ndaras e me vizë lidhëse në mes; - Shkurtesat dhe shkurtimi i fjalëve - Përdorimi i shenjave të pikësimit - drejtshkrimi
6. Morfologji	- Kategoritë gramatikore të fjalëve në gjuhën shqipe - Pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjerates
7. Leksikologji	- Fjalet dhe veçorite e saj
8. Sintaksë	- Struktura gramatikore e fjalisë (e thjeshtë dhe e përbërë) - Rendi i fjalëve (gjymtyrëve) në fjali
9. Frazologji	Frazologjizmat

3.2. LETËRSI

Qëllimet:

Nxënësi është i aftë për:

- zbatimin e diturive për karakteristikat dhe përfaqësuesit e periudhave të ndryshme të letërsisë kombëtare dhe botërore;
- interpretimin dhe komentimin kritik dhe kreativ të veprave letrare.

Nxënësi duhet:

- t'i qaset veprës letrare në mënyrë analitike-krijuese dhe kritike;
- të përcaktojë kontekstin e veprës letrare (vendin, kohën, zhanrin);

SHKENCA MBI LETËRSINË	
- Teoria e letërsisë - Folklori / miti Lirika - Letërsia popullore - Drama (vargje; prozë)Proza Epika (vargje; prozë)- - Lirika --Figurat stilistike - Llojet letrare shkencore dhe publicistika	
2. Shkenca e letërsisë	
3. Letërsia popullore	
4. Fillet e letërsisë kombëtare	Dokumentet e para të gjuhës shqipe
5. Letërsia e vjetër shqiptare	Letërsia filobiblrike
6. Humanizmi dhe renesansa 1. Marin Barleti	“Historia e Skenderbeut”

7. Letersia e Rilindjes kombetare 1. Pashko Vasa 2. Jeronim de Rada 3. Gavril Dara I Riu 4. Zef Serembe 5. Anton Santori 6. Naim Frasheri 7. Andon Zako Cajupi	“Bardha e Temalit” “Këngët e Milosaos” “Kënga e Sprasme e Balës” Poezia erotike “Emira” “Lulet e verës” “14 vjeç dhëndër “
9. LETËRSIA SHQIPE E GJYSMËS SË PARË TË SHEKULLIT XX 1. Gjegj Fishta 2. Migjeni 3. Kristo Floqi 4. Ali Asllani 5. Faik Konica 6. Fan Noli 7. Lasgush Poradeci	“Lahuta e Malcis” Proza “Vargjet e lira” “Vllazëri e interes” “Hanko Halla” “Doktor Gjilpëra” “Albumi” –poezi origjinale “Vallja e yjeve”; “Ylli I zemres”
11. Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore 1. Petro Marko 2. Dritëro Agolli 3. Ismail Kadare 4. Azem Shkreli 5. Ali Podrimja	“Hasta la vista” “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” “Poezi” “Lum lumi”
12. Letërsia botërore	I
Homeri Dante Aligieri	“Iliada” (Ndarja mes Hektorit dhe Andromahës) “Komedia hyjnore”
Xhorxh Gordon Bajroni Aleksandar S.Pushkini	“ Shtegtimet e Çajld Haroldit “ “Eugjen Onegjini”

Onore de Ballzaku Sharl Bodleri	“Xha Gorio “ “ Lulet e së keqës “
Edgar Alan Po	“Korbi “
Alber Kami A.P.Çehovi	“I huaji “ “Tregime të zgjedhura “

4. KONKRETIZIMI I QËLLIMEVE, DITURIVE DHE AFTËSIVE SIPAS LËMENJVE

4.1. TË SHKRUARIT

QËLLIMET	TEMA DHE SQARIME
1. Të shkruajë tekst me sintaksë të rregullt.	Të rregullohet sipas normave sintaksore teksti me radhitje të përmbysur.
2. Të shkruajë tekst sipas normave gjuhësore	Të përmirësojë gabime gjuhësore dhe drejtshkrimore, ;... të transformojë në gjuhën standarde shqipe tekst të shkruar në dialekt...
3. Të shkruajë tekste me qëllime praktike.	Lutje, letër, plotësim i formularëve të ndryshëm, biografi, deklaratë etj.
4. Të shkruajë hartim me shkrim për një temë të caktuar, duke shfrytëzuar për burime informata të ndryshme	Ekologji, film, muzikë, drogë, ndikimi negativ i mediave, ngjarje nga përditshmëria

4.2. TË LEXUARIT

QËLLIMET	TEMA DHE SQARIME
1. Ta përcaktojë llojin e tekstit në bazë të temës	- Prezanton fakte të dhëna; - Prezanton mendime; - Interpretin argumente
2. T'i identifikojë personazhet kryesorë, personalitetet dhe mendimet në tekst	- I analizon personazhet dhe personalitetet dhe mendimet në tekstin e dhënë .
3. Të zbulojë dallimin ndërmjet reales dhe funksionit të tekstit	- Dallon dhe lidh temën, personazhet, problemet;motivet e tekstit.
4. Të kuptojë rëndësinë dhe rolin e tekstit në të kaluarën dhe të tashmen	- Vlerëson aktualitetin e tekstit për sot në bazë të ngjarjes, gjuhës dhe stilit

4.3. LETËRSI

QËLLIMET	TEMA DHE SQARIME
1. Ta përcaktojë kronologjinë e ngjarjeve në një vepër letrare	- Fabula, syzheu, naracioni (linear, paralel etj.) - monologu i brendshëm, dialogu
2. Ta përcaktojë strukturën e kompozicionit në veprën letrare	- Strofa, soneti, akti, skena, kapitulli
3. Ta përcaktojë kohën dhe vendin e ngjarjes në veprën letrare (ngjarjet në veprën letrare)	- Ngjarja zhvillohet në të kaluarën, në të ardhshmen, në kohë të imagjinuar, në kohë reale dhe në vende të imagjinuara
4. Të analizojë personazhe sipas portretizimit të brendshëm dhe të jashtëm	- atributet e personazheve - personazhi- personazhe
5. Të përcaktojë temat dhe motivet në një tekst të caktuar letrar	Temat: - dashuria, tradita, identiteti etj.

4.4. TË FOLURIT

QËLLIMET	TEMA DHE SQARIME
1. Të bëjë prezantim të organizuar dhe të pavarur të një teme të caktuar .	- "Në çdo familje ka konflikte gjeneratash" - "Ç'është për të rinjtë veshja moderne?" - "Të drejtat e njeriut dalin nga obligimet e tij"
2. Të komentojë në mënyrë të pavarur.	- Shfaqje teatrale - Ndeshje sportive - Mbledhje - Koncerte - Artikull gazetaresk - Vepër letrare
3. Të zhvillojë diskutim të pavarur për një temë të caktuar.	- Për shembull: "Të drejtat e njeriut dalin nga obligimet e tij" - në rolin e liderit në diskutim: - hyrje në temën për diskutim. - udhëheq me diskutimin - në rolin e pjesësmarrësit - i prezanton qëndrimet dhe argumentet e veta.
4. Të interpretojë qëndrime dhe argumente në situata të ndryshme	- Situata kur duhet të pajtohet me argumentet e të tjerëve. - Reagon në situata varësisht nga roli që ka.
5. Të përdorë artikullim dhe intonacion të qartë për një temë të caktuar.	- Në të folurit spontan dhe - në të folurit e përgatitur - duhet të përdorë: - tekst logjik - gjestikulim - pauzë.

Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate

5. PËRSHKRIMI I PROVIMIT

5.1. STRUKTURA E PROVIMIT

Provimi përfundimtar nga gjuha shqipe dhe letërsia përbëhet prej tri pjesëve nëpërmjet të cilave vlerësohen katër (4) aftësi. Aftësitë e caktuara kanë proporcion të njëjtë në procesin e vlerësimit.

Aftësia **Të folurit** është pjesë interne e provimit dhe do të zhvillohet në shkollë sipas kriterëve të përcaktuara për realizimin e provimit dhe mënyrën e vlerësimit. Realizimi i provimit të kësaj aftësie duhet të fillojë në fillim të gjysmëvjetorit të dytë të vitit të katërt. Arsimtari i planifikon terminet dhe numrin e kandidatëve që do të japin provimin gjatë një dite. Vlerësimi i diturive dhe aftësive nga **Të folurit** do të bëhet sipas kriterëve të veçanta.

Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate.

Aftësitë **Të Lexuarit dhe Letërsia** janë pjesë interne e provimit që kanë numër të barabartë të pikëve. Aftësitë **Të lexuarit dhe Letërsia** janë pjesa e parë e provimit dhe testi do të përmbajë numër të pyetjeve përafërsisht të barabartë për të dyja pjesët në një test-librezë. Detyrat e provimit do të vlerësohen nëpërmjet çelësit të përgatitur me përgjigje të sakta.

Të shkruarit është pjesa e dytë interne e provimit dhe do të vlerësohet sipas kriterëve adekuate.

Pjesa interne: Të Folurit Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate

Pjesa interne:Të lexuarit, Letërsia, Të shkruarit.

Provimi përfundimtar përbëhet prej testeve - librezave me detyra të provimit nga të tria aftësitë e lartpërmendura.

5.2. KOHËZGJATJA E PROVIMIT

Pjesa interne: Test – librezat – 180 minuta

Të Folurit - koha e përgatitjes - 15 minuta
- nxënësi flet - 7 minuta

Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate

5.3. LLOJI I DETYRAVE TË PROVIMIT

Provimi përfundimtar nga gjuha shqipe dhe letërsia do të përmbajë detyra të provimit:

- detyra të llojit të hapur;
- detyra me alternativa përgjigjesh;
- me plotësime;
- me nënvizime;
- detyra të llojit të esesë (tekste të shkruara me numër të caktuar të fjalëve).

6. RRJETI SPECIFIKUES

Përmbajtjet programore	Aftësia 1	Aftësia 2	Aftësia 3	Aftësia 4	
	Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit	Letërsia (zbatimi dhe vlerësimi i termeve teoriko-letrare)	Gjithsej
GJUHË 50%	20%	5%	20%	5%	50%
LETËRSI 50%	5%	15%	10%	20%	50%
Gjithsej:	25%	20%	30%	25%	100%

7. MËNYRA E VLERËSIMIT

Numri i përgjithshëm i pikëve i provimit që mund të fitohet nga testet është në interval prej 80-100.

Përgjigjja e saktë e detyrave me më shumë zgjidhje (në të cilën nxënësi ka mundësi të përcaktohet vetëm për njërin përgjigje) vlerësohet me 1 pikë.

Përgjigjja e saktë në detyrat ku kërkohet përgjigje drejtpërdrejt e shkurtër (me një ose me më shumë fjalë), gjithashtu vlerësohet me 1 pikë.

Detyrat në të cilat kërkohet të paraqitet si zgjidhet ndonjë detyrë (situatë problematike), të diskutohet, të arsyetohet ose të vlerësohet ndonjë zgjidhje ose qëndrim, vlerësohen ashtu që ndaras vlerësohet zgjidhja e saktë në çdo fazë të përgjigjes së kërkesës së detyrës. Varësisht nga numri i kërkesës këto detyra vlerësohen me 2 ose 3 pikë.

Kjo ndarje e pikëve është prezente në kriteret e përgatitura në mënyrë eksterne të cilat do të përdoren për vlerësimin e detyrave të llojit të esesë.

Përfshihet aftësia **Të folurit** ku vlerësimin e përgjithshëm të kësaj aftësie e realizojnë vetë arsimtarët në shkollë duke u mbështetur në kriteret e vlerësimit të aftësisë së të **Të folurit***. Vlerësimi realizohet gjatë mbajtjes së provimit prej më së paku 2 arsimtarëve të gjuhës shqipe dhe letërsisë në bazë të kriterëve të vlerësimit të kësaj aftësie.

Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate

Numri i duhur i pikëve për kalimin e provimit vendoset në një shkallë për secilën nga notat pozitive (nga 2 deri në 5) dhe caktohet para fillimit të provimit .

* Për këtë aftësi ka dokument të veçantë– Programi i provimit për aftësinë e **Të folurit**

AFTËSITË TË CILAT VLERËSOHEN

Provimi përfundimtar nga gjuha shqipe dhe letërsia do t'i vlerësojë aftësitë e nxënësve në **Të folurit**, në **Të lexuarit**, në **Letërsi** dhe në **Të shkruarit**

TË FOLURIT

Qëllimi themelor i të **Folurit** është që t'i kontrollojë aftësitë e nxënësve për organizimin e prezantimit gojor në tema dhe situata të ndryshme.

Forma e provimit: pjesa me gojë e provimit përfundimtar

Mënyra e realizimit: interne

Format e të shprehurit me gojë: Të folurit (*tregimi*); *monologje të shkurtëra* (*fjalë hyrëse, lajm, diskutim, koment, raport*), *bisedimi ose dialogu: (bisedime zyrtare, intervista, debate, anketa, bisedime për tema të caktuara); llojet e veçanta të bisedimeve (fjalim solemn, fjalim përshëndetës).*

Realizimi i kësaj pjese do të fillojë pasi të krijohen kushte adekuate

TË LEXUARIT

Qëllimi themelor i aftësisë **së Të lexuarit** është që t'i kontrollojë aftësitë e nxënësve për qasje analitike dhe sintetike në tekstet ose veprat e dhëna; dallimi i teksteve: për nevoja individuale (udhëzime, letra, biografi); për përdorim publik (rregullore, ligje); për nevoja arsimore (tekste shkollore, leksikone, enciklopedi, fjalorë etj).

Forma e provimit: pjesë me shkrim e provimit përfundimtar.

Mënyra e realizimit: interne

LETËRSIA

Qëllimi themelor i aftësisë **Letërsi** është t'i kontrollojë aftësitë e nxënësve për interpretimin e një vepre të caktuar letrare; të krahasojnë vepra nga lloje të ndryshme të letërsive kombëtare; të dallojnë karakteristikat e drejtimeve të caktuara letrare etj.

Forma e provimit: pjesë me shkrim e provimit përfundimtar

Mënyra e realizimit: interne

TË SHKRUARIT

Qëllimi themelor i aftësisë **së Të shkruarit** është t'i kontrollojë aftësitë e nxënësve në lëmin e të shprehurit me shkrim për tema dhe forma të ndryshme; hartimi i konceptit; mbajtja e shënimeve.

Forma e provimit: pjesë me shkrim e provimit përfundimtar

Mënyra e realizimit: interne

KRITERET PËR VLERËSIMIN E AFTËSISË TË SHKRUARIT

- Kandidati e humb te drejtën për t'u vlerësuar sipas kriterëve të parashikuara të aftësisë së të shkruarit, po qe se përmbajtja e teksteve nuk përputhet me temën e dhënë.
- Kandidati e humb te drejtën për t'u vlerësuar sipas kriterëve të parashikuara të aftësisë së të shkruarit, po qe se teksti i shkruar për destinim praktik nuk e plotëson formën e kërkuar.
- Kandidati e humb te drejtën për t'u vlerësuar sipas kriterëve të parashikuara të aftësisë së të shkruarit, po qe se numri i fjalëve në tekstin e shkruar është më i madh se numri i parashikuar në Udhëzimin për vlerësim për vitin konkret të provimit.

Kriteret e vlerësimit	Treguesit e kriterëve	Detyra e vlerësuesit
1. Gjuha - - gjithsej 2 pikë drejtshkrimi dhe shenjat e pikësimit - 1 sintaksa - 1	1. Drejtshkrimi: - përdorimi i germës së vogël dhe i germës së madhe; - të shkruarit e fjalëve në mënyrë të bashkuar apo të ndarë; - ndarja e fjalëve në fund të rreshtit ; - drejtshkrimi i fjalëve; - përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit. 2. Sintaksa - kompozicioni sintaksor i drejtë i fjalisë dhe përdorimi funksional i saj.	Vlerësuesi me kujdes duhet: - t'i zbulojë dhe t'i klasifikojë gabimet në tekst sipas sqarimit të dhënë; ta përcaktojë peshën dhe përsëritjen e gabimeve (me përsëritje nënkuptohen gabimet që përsëriten disa herë, p.sh. <i>burr</i> në vend të <i>burrë</i>); gabimi i përsëritur numërohet një herë. - ta vlerësojë kompozicionin sintaksor të drejtë të fjalisë (renditjen e drejtë të fjalive; përdorimin e lidhëzave përkatëse, renditjen e drejtë të fjalive të nënrenditura – fjalitë në periudha).
2. Kompozicioni i tekstit - gjithsej 2 pikë	Në tekst ndahen në mënyrë të qartë: - hyrja - pjesa kryesore - përfundimi / rregullimi i paragrafëve me fjali këpujore 1 pikë - respektimi i kufirit të numrit të parashikuar të fjalëve 1 pikë	Vlerësuesi me kujdes duhet: - ta konstatojë praninë e që të tri pjesëve të kompozicionit; ta vlerësojë lidhshmërinë dhe renditjen e pjesëve; ta vlerësojë rregullimin e tekstit sipas paragrafëve, duke vlerësuar praninë e fjalive këpujore; - të konstatojë nëse nxënësi ka përdorur numër të duhur fjalësh.

3. Kreativiteti në përmbajtje - gjithsej 9 pikë - të kuptuarit e temës - zhvillimi i temës - lidhja kreative e pjesëve dhe e përmbajtjes - fokusimi në idenë kryesore të temës - elementet origjinale dhe kreative në stilet letrare dhe jo letrare - respektimi i kërkesave të përcaktuara - leksik përkatës	Në tekst lexohet: -të kuptuarit e temës duke përdorur shembuj përkatës si prova të shtjellimit të temës. - 2 pikë -shtjellimi i temës me ide dhe argumente që rëndësi themelore për domethënien e temës 1 pikë - mendime kritike të ndërlidhura në mënyrë kreative, duke përdorur fakte të sakta që kanë të bëjnë me temën 2 pikë - të theksuarit (fokusimi në) e idesë themelore në përpilimin e tekstit duke i lidhur pjesët në mënyrë origjinale dhe kreative - 1 pikë - përdorimi përkatës i stileve letrare dhe jo letrare në kontekstin e temës në të cilën ka origjinalitet dhe kreativitet - 1 pikë - krijimi i tekstit që përputhet me kërkesat konkrete, të përcaktuara në Udhëzim -1 pikë - Përdorimi i leksikut që përputhet me llojin e tekstit dhe me temën - 1 pikë	Vlerësuesi me kujdes duhet: - ta vlerësojë të kuptuarit e temës dhe shtjellimin e saj në tekst; - ta vlerësojë përputhshmërinë e përmbajtjes në pjesët e kompozicionit; - t'i vlerësojë faktet, idetë, pyetjet dhe përgjigjet e paraqitura në tekstin e dhënë. - ta vlerësojë kreativitetin e paraqitur në tekst - t'i vlerësojë elementet origjinale dhe kreative - me shprehjen <i>leksik</i> përkatës nënkuptohet: përfshirja e fjalëve, e frazave dhe e ndërkombëtarizmave të ndryshëm dhe përdorimi përkatës i tyre.
---	---	--

ë

